



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA FIER**

Nr. 9665 Prot.

Tiranë, më 24.07.2026

**Lënda:** Aplikim për treguesit e Grantit Bazuar në Performancë 2026

**Drejtuar:** Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV)

Të nderuar,

Në vijim të shkresës suaj me Nr. 331 Prot., datë 18.06.2026, lidhur me zbatimin e Udhëzimit të Përbashkët nr. 1, datë 10.6.2026 *“Për kriteret, procedurat dhe treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për Bashkitë për vitin 2026”*, Bashkia Fier po aplikon në lidhje me Grantin e Bazuar në Performancë për vitin 2026.

Përmes kësaj shkrese zyrtare, ju përcjellim bashkëlidhur dokumentacionin (shkresor dhe CD) për aplikimin e treguesve të GBP 2026, si më poshtë:

**Komponenti I – Planet vendore të dorëzuara nëpërmjet linkut të publikimit ose kopje fizike.**

**1. Plani i Menaxhimit të Pyjeve:**

- Urdhri i Ministrisë së Mjedisit.

**2. Plani Vendor Social:**

- Vendimi i Këshillit Bashkiak
- Konfirmimi i Prefektit.

**3. Plani Vendor i Arsimit  
Parauniversitar:**

- Vendimi i Këshillit Bashkiak;
- Konfirmimi i Prefektit

**4. Plani Vendor i Integritetit:**

- Vendimi i Këshillit Bashkiak.

**5. Plani Vendor i Barazisë Gjinore:**

- Vendimi i Këshillit Bashkiak.
- Konfirmimi i Prefektit

## Komponenti II – Tregues të Matshëm Rezultati

7. **Shkalla e regjistrimit të fëmijëve në kopshtet publike është jo më e vogël se 60% për vitin 2025** – disponohet nëpërmjet Sistemit të Matjes së Performancës 2025 të raportuar AMVV-së.
8. **% e riciklimit të të ardhurave nga ekonomia pyjore të realizuara me planifikimin/fakt në këtë sektor është më e vogël se 70% për vitin 2025** - disponohet nëpërmjet Sistemit të Matjes së Performancës 2025 të raportuar AMVV-së.
9. **Të paktën 50% e mbulimit të kostos nga tarifa për menaxhimin e mbetjeve** - disponohet nëpërmjet Sistemit të Matjes së Performancës 2025 të raportuar AMVV-së.
10. **Shtimi i shërbimeve sociale sipas kategorisë së bashkisë ( 3 shërbime të reja)** – disponohet dokumentacion: 3 kontrata gjatë periudhës 1 janar 2025 – 30 qershor 2026.
11. **Paketa e emergjencës për viktimat e dhunës, e planifikuar në buxhetin e 2026-ës** – disponohet buxheti i miratuar me Vendim Këshilli Bashkiak.
12. **Bashkia ka raportuar të dhënat përkatëse për të gjithë treguesit e Raportit Kombëtar të Performancës 2025 brenda afatit të përcaktuar në udhëzim – SMP 2025.**
13. **Bashkia ka shlyer detyrimet e prapambetura me të paktën 30 %, në peridhën referuese nga data 31.12.2025-30.06.2026** – disponohet nga Ministria e Financave.
14. **Rritja me të paktën 20% e të ardhurave nga taksa mbi pasurinë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025** - disponohet nga Ministria e Financave.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KRYETAR  
ARMANDO SUBASHI**

